

1.

Shqipëria ime.

Të dua Shqipëri:
për këmbënguljen tënde,
për shqiponjën dykrenare,
për flamurin
kuq e zi
që e mbajmë
në gji ...

E kaluara jote
nuk ishte e lehtë,
ndarjet,
kryengritjet, luftërat,
e megjithatë
vazhdove
të jesh e fortë
me shekuj,
Nëna e jonë e vërtetë.

Faleminderit Shqipëri:
për luftëtarët dhe ushtarët trima,
për të mençurit
dhe të diturit,
për Skënderbeun,
dhe për Naimin.

Faleminderit Shqipëri:
për diellin e artë,
malet dhe
zhurmën e detit,
për liqenjtë e shumtë,
dhe borën e veriut, që shkëlqen
tërë atdheun.

Faleminderit për parqet, rrugët dhe shkollat.
Të dua Shqipëri,
sa e bukur je,
Ti na jep shpresë çdoherë
për një,
ditë të re .

Edhe pse,

shumë vjeç
larg teje jam,
në zemër të kam.

Haxhi Dulla

2.
Një vend i bukurë
e i dashur

O flamur,
kuq e zi
me simbole atdhetare,
i kuq si gjaku,
dhe në mes
një shqiponjë
dy krenare,
që mbulon me krahët e saj
të gjithë
bijtë e bijat
të atdheut
të lirë,
të sigurt,
e të dashur.

Gjithëherë
sapo zgjohem
në agim,
e shikoj me admirim
portretin
e më të madhit,
ndër,
shqiptarët
trim.

Shqipëria është
një vend i bukurë,
një parajsë e vërtetë,
ndaj ta duam o vëllezër
si thesar përjetë.

Haxhi Dulla

